

FJALA E DEPUTETES KLOTILDA BUSHKA

E HËNË 23 MAJ 2022

Nuk jam dakord me disa nga kolegët parafolës të maxhorancës, të cilët thanë se i falënderojnë kolegët e opozitës, sepse kështu bëmë një informim të mirë publik për projektin. Në fakt, ajo çfarë bëtë ju, kolegë të opozitës, ishte modeli më i keq i informimit publik. Ky ishte modeli i dezinformimit publik dhe dezinformimi publik nuk i shkon për shtat interesit publik, sepse ky ishte modeli i stisjes së argumenteve për të shtrembëruar të vërtetën me qëllim të keq, nuk kishte qëllim të mirë.

Unë dua të përgëzoj ministren Kumbaro, ish-ministre e Kulturës, e cila pati vizionin për ligjin e trashëgimisë kulturore, të cilin e miratuam në këtë sallë. Atje parashikuam standardet më të mira, që përdorshin si modele në botë, për të menaxhuar pasuritë kulturore, sipas standardeve më të mira të konventës së Parisit. Dua të përgëzoj dhe të falënderoj ministren Margariti, e cila këtë vizion e përktheu në veprime konkrete! Ajo në mënyrë perfekte ka zbatuar legjislacionin, kuadrin rregullator në përmbushje të interesit publik. Kjo është një marrëveshje për menaxhimin e një pasurie kulturore kombëtare, nuk është as koncesion dhe as marrëveshje ekonomike partneriteti publikprivat.

Këtu bëhet fjalë për bashkimin e njohurive, në zbatim të një modeli, që është jofitimprurës, i cili jo vetëm e ruan, jo vetëm e optimizon një vepër të trashëgimisë kulturore, por i jep asaj mundësinë të përmirësohet, t'i shërbejë komunitetit dhe ta rrisë imazhin e Shqipërisë në botë për një menaxhim të shkëlqyer, sipas asaj që prezantohet në këtë marrëveshje. Ne sot do të miratojmë një marrëveshje mes Ministrisë së Kulturës dhe një fondacioni jofitimprurës. Në këtë fondacion një nga themeluesit është ministria dhe si bashkëthemelues është një fondacion shumë prestigjioz shqiptaro-amerikan. Po të lexonit dhe po të merrnit informacionin e saktë, ministrinë do ta shikoni në dy pozicione: në pozicionin e përfaqësuesit shtetëror, i cili është palë në këtë marrëveshje, që vjen në Kuvend dhe merr miratimin tonë, kërkon llogari për zbatimin e detyrimeve të nënshkruara në marrëveshje, në përmbushje të qëllimit, të ruajtjes dhe optimizimit të një pasurie kombëtare; nga ana tjetër është edhe palë me fondacionin, ku merr pjesë direkt në vendimmarrjet e përditshme të fondacionit.

Nëse i hyjmë logjikës suaj, që ne ia dhamë privatit, bëni pak llogaritë e peshës së vendimmarrjes, ku shkon? Ministria është palë në kontratë; ministria është bashkëthemeluese në një fondacion. Çdo argument që dëgjoj e trilloni dhe e përcillni, me qëllim shtrembërimin e fakteve të vërteta dhe hyni në

analizën e statutit të fondacionit. Pra, ngatërroni rregullat e organizimit të një fondacioni jofitimprurës me rregullat e një marrëveshjeje që do të kthehet në ligj, sepse do të miratohet këtu.

Ju thoni: “Fondacionet nuk kontrollohen”, jo, nuk është ashtu, sepse po të lexoni Kodin Civil dhe ligjin për OJF-të, fondacionet janë objekt i kontroleve dhe i mbikëqyrjes shtetërore, sipas legjislacionit fiskal, sipas legjislacionit të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, kur një fondacion ushtron veprimtari publike, jep shërbime publike apo kur përdoren edhe fonde të buxhetit të shtetit, ose pasuri kombëtare. Fakti që palët kanë rënë dakord të japin një nivel më të lartë mbikëqyrjeje, përveç legjislacionit shqiptar, që auditin e punës së fondacionit ta bëjë një nga kompanitë e listuara si më prestigjiozet, në kuptimin e auditimit ligjor dhe financiar, siç janë “Big four”, që quhet në gjuhën teknike, është një vlerë e shtuar, është një tregues i përgjegjshmërisë më të lartë të ministrisë për ta vendosur këtë, por kjo nuk do të thotë se ky fondacion është imun nga legjislacioni aktual në fuqi.

E dyta, që është shumë e rëndësishme, çështja e pronësisë së tokës. Po çfarë lexoni? Më thoni një nen, ku fondacioni bëhet pronar i kësaj pasurie? Nuk ka. Çfarë lexoni ju? Ju në legjislacionin tonë lexoni të drejtat e administrimit, që përfshihen në të drejtat reale të pronësisë. Ai do të regjistrohet, në mënyrë që fondacioni për 10 vjet, në kuadër të një marrëveshje menaxhimi, të jetë i ligjshëm, që të mos i shkojë dikush nesër dhe t’i thotë që nuk e ke të drejtën e administrimit, si çdo kontratë tjetër e kësaj natyre. Më gjeni një nen? E keni pyetur disa herë ministren dhe jua ka thënë. Ministria ka përgjegjësi përballë publikut dhe përballë jush, ajo nuk mund të gënjejë, siç gënjeni ju kaq lehtë. Nuk ka një nen, nuk ka një deklaratë, por “la carta canta”, nuk më duhen as deklaratat.

Nenet e marrëveshjes që miratojnë sot nuk parashikojnë në asnjë moment kalimin e pronësisë së sitit të Butrintit, ato e thonë e zeza në të bardhë, lexojini nenet, që pronësia i mbetet shtetit shqiptar. Thoni që nuk ka kontroll, po si nuk ka kontroll, është e zeza mbi të bardhë, në marrëveshje janë të gjithë mekanizmat e kontrollit që ka ministria dhe autoritetet shqiptare dhe si do të zbatohet kjo marrëveshje. Përveç kësaj, do të jenë edhe sa e sa veprimtari të tjera, që lidhen me parkun e Butrintit, si veprimtari: arkeologjike, zbuluese, optimizuese e të tjera, që do të bëhen në kuadër të zbatimit të kësaj marrëveshjeje, me miratimin paraprak të autoriteteve shqiptare. Pra, keni një marrëveshje të fondacionit, të nënshkruar me Institutin e Arkeologjisë dhe me institucione të tjera të shtetit. Nuk mund të bëhet asnjë punë në Butrint pa marrë miratimin paraprak të këtyre autoriteteve përgjegjëse. Unë nuk e kuptoj përse nuk doni ta pranoni që gabuat kur filluat ta kundërshtonit këtë model, tek e fundit u nisët nga një qëllim i mirë, lexuat rrugës dhe e kuptuat që ishte gabim, por të paktën pranojini ato gjëra, që janë e zeza mbi të bardhë të shkruara në letra.

Çfarë më çudit tjetër? Ju flisni për partneritet privat-publik, kur jua shpjegova se po flasim për një fondacion me bashkëthemelues Ministrinë e Kulturës dhe një institucion shumë prestigjioz, krijuar me vendim të Kongresit Amerikan, Fondin Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve, i cila ka 4 programe kryesore, si dhe 30 vjet që punon në Shqipëri: edukim, sipërmarrje, leadership, turizëm kulturor dhe ekologjik. Neni 171 i ligji “Për trashëgiminë kulturore”, e zeza në të bardhë. Unë nuk e di se çfarë ju shtyn akoma të vazhdoni në këtë kokëfortësi, ku çdo fakt dhe çdo diskutim jua ka nxjerrë në shesh gabimet që keni?! E thotë qartë neni 172 “Fondacionet e posaçme të trashëgimisë kulturore”: “Administrimi i pasurive të trashëgimisë kulturore mund të kryhet nga persona juridikë jofitimprurës, të bashkëthemeluar ndërmjet institucioneve shtetërore, përfaqësuar nga ministria përgjegjëse, për trashëgiminë kulturore, dhe personat fizikë juridikë vendas apo të huaj, sipas rregulluarve të parashikuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi.

Administrimi ka për qëllim mbrojtjen, ruajtjen, restaurimin, vlerësimin e pasurive kulturore dhe dhënien në përdorim të drejtpërdrejtë në mënyrë joshteruese”. Ku është kundërshtimi në këtë dispozitë? Çfarë po bën ky propozim, që na ka sjellë sot qeveria për miratim? Po bën zbatimin e nenit 172. Kur flasim, duhet edhe të lexojmë, unë nuk marr përsipër të flas për gjëra që nuk jam e informuar, nuk i kam lexuar dhe nuk i njoh. Përpara se të vija këtu kam lexuar se, përpara se të arrihej në miratimin e këtij projektligji, i cili i jep rrugë një marrëveshje mes Ministrisë së Kulturës dhe fondacionit të bashkëthemeluar nga Ministria e Kulturës, Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndërmarrjeve, është kaluar një procedurë rigoroze ligjore, janë bërë marrëveshje me institucionet përkatëse shqiptare, janë bërë konsultime publike, janë marrë miratime nga entet të ndryshme, janë marrë vendime në nivelin e Këshillit të Ministrave, ka një plan biznesi të miratuar sipas ligjit.

Pra, po ta marrim me rrallë kronologjike, nëse nuk gaboju, janë më shumë se 22 veprime ligjore administrative, që i kanë paraprirë kësaj marrëveshjeje, për të treguar seriozitetin e mirë dhe vullnetin e duhur, që kjo marrëveshje t’i shërbejë qëllimit të saj. Cili është qëllimi i kësaj marrëveshjeje, se i çmendëm qytetarët me këtë “furtunë në gotë” siç thanë kolegët e mi? Të administrojmë në zonën e trashëgimisë kulturore dhe në peizazhet kulturore, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit. Ky është qëllimi. Butrintin do ta kthejmë në një model edhe në praktikë, siç patëm vizionin të bëjmë ligjin për këto forma menaxhimi, siç ministria ka vizionin t’i kthejë në realitet; do të vijë edhe faza e tretë, ku ne do të jemi krenar të gjithë për Butrintin. Kam frikë se atëherë ju nuk do të flisni më, siç keni dalë për të bërë kritika për shumë vepra të bukura publike, që sot i gëzoni me fëmijët tuaj, ashtu si të gjithë ne, dhe bëni shumë mirë, se janë në shërbim të publiku, se ne nuk i kemi ndarë ndonjëherë qytetarët në grupe.

Por e vërteta është se kështu do të ndiheni edhe për Butrintin. Kur Butrinti të fillojë të ndihet si një vepër e optimizuar me këtë model pozitiv, kur Butrinti të na bëjë krenarë edhe në nivel ndërkombëtar, ne do t'u kërkojmë ministrisë dhe qeverisë shqiptare që edhe Amfiteatrin e Durrësit dhe vende të ngjashme t'i optimizojë në të njëjtin model. Faleminderit!